



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:156662
Datë: 16.10.2024
Numri i dokumentit: 06310069

Cn.nr.463/2016

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen jokontestimore sipas propozimit të propozuesit D.Q. me nr. personal ... nga fshati Romajë, komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. E.G. nga Prizreni, lidhur me propozimin për caktimin dhe rregullimin e megjëve, jashtë seance, me datë 16.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET i tërhequr propozimi me numër të dosjes Cn.nr.463/2016 i propozuesit D.Q., nga fshati Romajë, komuna e Prizrenit, lidhur caktimin dhe rregullimin e megjëve.

A r s y e t i m

Propozuesi D.Q. nga fshati Romajë, komuna e Prizrenit, nëpërmjet të autorizuarit të tij av. E.G. nga Prizreni me datë 10.08.2016, pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozimin për caktimin dhe rregullimin e megjëve.

I autorizuari i propozuesit av E.G. me parashtrësën e datës 14.10.2024 ka bërë tërheqjen e propozimit duke theksuar se çështja jo kontestimore është zgjidhur në një formë tjetër.

Me nenin 3 të ligjit për procedurës jokontestimore, parashihet: *“Në procedurën jokontestimore përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe”*. Ndërsa me nenin 261 të LPK-së, parashihet: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* Në neni 12.1 të ligjit për procedurës jokontestimore parashihet që *“Propozimi me të cilin është inicuar procedura mund të tërhiqet derisa të jepet aktvendimi i shkallës së parë për zgjidhjen e çështjes”*.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 261 pika 1 dhe 3 të LPK-së dhe neni 12 i LPJK-se, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për të konstatuar se propozuesi e ka tërhequr propozimin e datës 10.08.2016.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2019:156662
Datë: 16.10.2024
Numri i dokumentit: 06310069

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i përgjithshëm
CN.nr.463/2016, datë 16.10.2024

Gjyqtari

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, bazuar në nenin 261.4 të LPK-së.